



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS – SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-32904/23 datë: 22.12.2023



Npi – 01/482 datë: 26.12.2023

Duke u bazuar në nenin 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/155 datë: 27.04.2023, Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 26.12.2023, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -XII- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE
E mbajtur më: 26.12.2023 (e martë) në ora 14:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi, z.Bajram Ilazi, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Rrezartë Ramadani, znj.Shkurte Mustafa, znj.Shkurte Behluli, z.Muhamet Mehmeti, z.Arton Demiri. Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit kanë marrë pjesë edhe: Nga zyra për informim znj.Vlora Hyseni dhe praktikantet znj.Valmira Hoxha dhe znj.Sadbere Halili. Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit z.Bajram Ilazi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin prej 7 anëtarëve të Komitetit prezent në mbledhje. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK-se më 24.11.2023,
2. Diskutim për Draft-Rregullore për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim më pak se një vit të pronës Komunale, (Pas diskutimit publik)
3. Diskutim për Draft-Rregullore për Procedurat dhe Kriteret për zgjedhjen e Laureatëve të vitit në sport, (Pas diskutimit publik)
4. Diskutim për 15 shkurtin – Dita Nacionale e komunitetit Ashkali,
5. Raporti i punës së KPK-së për vitin 2023, nga Kryesuesi i KPK-së,
6. Draft – Plani i Punës së KPK-së për vitin 2024,
7. Propozim – vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të rregullta të KPK-së për vitin 2024,
8. Të ndryshme.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, prapë po shprehi shqetësimin tim për mungesën e drejtorëve në mbledhje. Prandaj propozoj që pikat 2 dhe 3, të hiqen nga rendi i ditës sepse nuk i kemi drejtorat.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Ne mundemi me i rekomandu Kuvendit për aprovim pikat 2 dhe 3. Propozojë që edhe këtë mbledhje ta përmbyllim për vitin 2023 dhe të shpresojmë që në vitin 2024 punët do të shkojnë mirë dhe mbarë. Ju falenderojë juve anëtarëve të Kuvendit për bashkëpunimin.

***Komiteti për Komunitete, me 6 vota “Për”, me 0 vota “Kundër”, dhe me 1 votë “Abstenim” miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK-se më 24.11.2023

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Para se të hapi diskutimin kërkoi një ndryshim në Procesverbal të rekomandimit për hartimin e planit veprues për përfshirjen e Komitetit të bëhet njëjtë me rekomandimin.

***Komiteti për Komunitete, unanimitisht miratoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja e KPK-se më 24.11.2023, me vërejtjen e z.Bajram Ilazi.**

Pika 2

Diskutim për Draft-Rregullore për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim më pak se një vit të pronës Komunale, (Pas diskutimit publik)

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Komunitete unanimitisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit miratimin e Rregullores për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim më pak se një vit të pronës Komunale.**

Pika 3

Diskutim për Draft-Rregullore për Procedurat dhe Kriteret për zgjedhjen e Laureatëve të vitit në sport, (Pas diskutimit publik)

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Seferi; Kjo rregullore ka me ua lehtësu punën Laureatëve sepse ka dal nga drejtoria e Kulturës, Rini dhe Sportit. E rëndësishme është që brenda kësaj të jenë përfitues ata të cilët e meritojnë sepse kemi shumë të reja dhe të rinjë, sepse është një rregullore ku i ka brenda të gjitha.

***Komiteti për Komunitete unanimitisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit miratimin e Rregullores për Procedurat dhe Kriteret për zgjedhjen e Laureatëve të vitit në Sport.**

Pika 4

Diskutim për 15 shkurtin – Dita Nacionale e komunitetit Ashkali

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Muhamet Mehmeti; Jemi bërë bajat duke bërë rekomandime por prapë se prapë spo arrijmë të bëjmë asgjë. Sa i përket 15 Shkurtit kam qenë 6 vite kordinator. Në këtë vitë kemi menduar se nuk do të bëhet 15 Shkurti, e kësaj here është shumë problem me u bë. Nqoftëse këtë vit nuk festohet ne do të mundohemi të gjejmë mjete e kjo neve po na kushton shumë.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Një prej rekomandimeve që deshta me e bë është që kësaj here me u organizu DKRS-ja në bashkpunim me zyren e Komuniteteve për ditën e 15 shkurtit.

z.Besnik Seferi; Pajtohem me ty Bajram që kjo festë të organizohet.

***Komiteti për Komunitete unanimitisht vendosi t'i Rekomandoi Drejtoris për Kulturë Rini dhe Sport që së bashku me Zyrën e Komuniteteve të organizon 15 Shkurtim ditën nacionale të Komunitetit Ashkali.**

Pika 5

Raporti i punës së KPK-së për vitin 2023, nga Kryesuesi i KPK-së

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Dhe shpjegoi raportin Janar - Dhjetor të KPK-së. Ne e kemi përmbushur 70% e planit të punës ndërsa pjesa tjetër ka qenë mosbashkëpunim me drejtorët dhe Kryetarin. E falënderoj Zyrtarin e Kuverndit z.Idajet Rexhepin dhe stafin e tij që më ndihmon shumë sidomos me raporte.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi Raportin e punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2023 nga Kryesuesi i Komitetit.**

Pika 6

Draft – Plani i Punës së KPK-së për vitin 2024

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Në këtë vitë u shtua në planin e punës edhe vizitë në qendrat mësimore.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi Planin e Punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2024.**

Pika 7

Propozim – vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të rregullta të KPK-së për vitin 2024

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Fjalën ja dha fjalën znj.Rrezartë Ramadani.

znj.Rrezartë Ramadani; Ne kemi bërë një orar për dy Komitete dhe kemi vendosur që këto dy Komitete ti mbajnë mbledhjet në një ditë me orare të ndryshme. Komiteti për Komunitete t'i mbajnë mbledhjet në ora 14:00 ndërsa Komitetit për Politikë dhe Financa t'i mbajnë mbledhjet në ora 09:00. Kjo bëhet për shkak që sekretaria e Kuvendit me i përgditë rekomandimet më herët për Kuvend.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi Propozim – vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të rregullta të Komitetit për Komunitete për vitin 2024.**

Pika 8

Të ndryshme

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Seferi; Unë kisha propozu që të marrim një iniciativë për shërndarjen e dhuratave fëmijëve të Komuniteteve Rom-Ashkali nëpër shkolla.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Jam shumë pro kësaj iniciative. Unë e përkrahu propozimin por që, nuk jeni të obliguar kjo është krejt sipas dëshirës se kush ka vullnet dhe mundësi.

z.Besnik Seferi; Pyetje për ZKKK-në sa është buxheti që ka mbetur në këtë zyre duhet të na japin një sqarim.

z.Muhamet Mehmeti; U kamë një buxhet 2,440 euro që ka mbetur, unë kam thënë se ky buxhet të shfrytëzohet, e di që kanë qenë 7 kërkesa.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Meqenëse diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 15:26h duke ju uruar festat e fundvitit.

Procesmbajtës
Valmira Hoxha



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi
